

19.10.18

P.nr.2614/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJKAT THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në lëndën penale kundër të pandehurit H. A për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6, lidhur me par. 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH –së, në Prizren, PP/II.nr.2046-2/16 të datës 29.11.2016, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 08.10.2018, merr këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri H. A nga i ati Sh dhe e ëma Z e vajzërisë B i lindur me datë në Prizren, ku dhe tani jeton, në rr. ””, ka të mbaruar shkollën e mesme, i martuar, ujësjellës, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datën 21.07.2016, rreth orës 23:30 min., në rrugën lokale në fshatin Komuna e Prizrenit, në afërsi të Qendrës Tregtare duke mos iu përmbajtur dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel Ligjin mbi Trafikun Publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve, vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR-së, duke mos ja parashtruar shpejtësinë kushteve ekzistuese në komunikacion, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “VW Caddy”, me targa të regjistrimit kur arrin në vendin kritik, nga pakujdesia, humb kontrollin ndaj automjetit të tij dhe pjesërisht del jashtë rrugës ku me pjesën e përparme të automjetit të tij përplasat në shtyllën elektrike e cila ishte jashtë rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes së automjetit, me ç’rast si pasojë lëndime të lehta trupore person bashkudhëtarja e tij – e dëmtuara D. A dhe atë lëndime të përshkruara së mendimin dhe konstantimin e ekspertit mjeko-ligjor të dt. 02.10.2016.

-Me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 të KPPK-se, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr. 2406-2/16 të datës 29.11.2016.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 4,41,43 par.1 pika 1.3, nenit 46,73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par. 1, të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit H. A ia shqipton:

DENIMIN ME GJOBË

Në lartësinë prej 140€ (njëqind e katërdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobe nuk realizohet as detyrimisht, atëherë gjykata konform nenit 46 par.3 të KP-së, dënimin me gjobë në lartësi prej 140 € do ta zëvendëson me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € nga dënimi me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

E dëmtuara D. A nga Prizreni me banim në rrugën "Jashar Salihu" nr.4, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, për ekspertizën mjeko – ligjore në shumën prej 20.00 €, ekspertiza e komunikacionit në shumën prej 40.88€, dhe për fondin për kompenzimin e viktimave në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me nr. PP/II.nr. 2046-2/16 të datës 29.11.2016, kundër të pandehurit H. A për veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6, lidhur me par. 1 të KP-së, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do t'i shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-se, në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë në mendimet e ekspertit mjeko – ligjor Dr. N. H. të datës 02.10.2016, përkitazi me natyrën e lëndimeve që ka pësuar e dëmtuara, mendimi dhe konstatimin e ekspertizës të ekspertit të komunikacionit ing. S. Sh. të dhënë me datë 05.10.2016, dhe foto-dokumentacioni, u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë vepër penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par. 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Me sa u tha me larte, ne kuptim te nenit 365 te KPP-se, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2614/2016, me datë 08.10.2018

B. Profesional,
Arlind Sharani



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Prizren. Po që se i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.